

**QËNDRA KRYESORE E MJEKËSISË
FAMILJARE “Dr. HAFIR SHALA”
D R E N A S**

**PLANI I PUNËS
PËR VITIN 2018**

Drenas, Janar 2018

Bazur ne nenin 22, 23,26 , 28 dhe 29 të Ligjit për shendetësi të Republikës së Kosovës, nenit 15 të Statutit të QKMF-së “Dr.Hafir Shala” ne Drenas, Këshilli drejtues me datë :20.01.2018 miratoi

P L A N I N E PUNËS PËR VITIN 2018

- I. Në këtë Plan të punës përfshihen të gjitha punët dhe detyrat tek të gjithë personeli (punëtorëve profesional shëndetësor, punëtorëve ndihmës shëndetësor dhe stafit udhëheqës), e cila punë do të jetë vazhde e mbarvajtjes së punëve ne këtë institucion, për çka edhe kerkohet nga I gjithë stafi të jetë përkrahës dhe zbatues.
- II. Në këtë Plan përfshihen qellimet dhe principet e punës në ofrimin e shërbimeve dhe kujdesit parësor –shëndetësor të qytetarëve të komunës së Drenasit e më gjerë, duke u bazuar ne aktet ligjore, U.A., Rregulloret , si dhe performancën e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- III. QKMF “Dr.Hafir Shala” në Drenas është institucion shëndetësor me interes të veçant, e që ushtron veprimtarin e vet kryesisht duke u bazuar ne Planin e punës si dhe në Projekt –Programet e departamenteve, sektoreve dhe njisive punuese, apo zyreve dhe shërbimeve tjera si:
 - Percjellë dhe studion gjendjen shëndetësore, kushtet higjenike dhe ambientale te popullates
 - Zbaton masat për mbrojtjen shëndetësore prenatale,antenatale dhe postnatale të femrave,planifikimin familjar, kujdesin për shëndetin e foshnjeve (zingjiri I ngroht),
 - Kujdeset per shendetin e fëmijëve dhe implementimi I programit te MISF-it deri ne moshen 5 vjeqare,kujdesi per femijet parashkollor dhe shkollor,me theks te veqant adoleshentet, studentëve, promovimin e stilit te shendetshem te jetes si dhe edukimin e tyre për dëmet e pierjes së duhanit, alkoolit, drogave;
 - Kujdesi per shendetin dhe mireqenjen e Invalidëve, personave me aftësi të kufizuara, punëtorëve ,kujdesin shtepiak dhe ate paliativ;
 - Zbaton programin e imunizimit dhe vaksinimit sipas kalendarit të vaksinimit;
 - Zbulon , parandalon dhe menaxhon me kohë sëmundjet ngjitëse, infeksionet seksualisht transmiseve HIV/AIDS dhe sëmundjet tjera .
 - Bënë edukimin e vazhdueshëm profesional te stafit si dhe ben edukimin e komunitetit sipas programeve edukativo-shendetsor;
 - Zbaton masat me qëllim të parandalimit të sëmundjeve të dhëmbëve dhe gojës, si dhe edukimin e vazhdueshëm profesional te stafit përmes programeve që dalin nga Ministria e Shëndetësisë,si dhe edukimin shendetsor te femijve parashkollor-shkollor permes ligjeratave dhe duke shperndar material promovues;
 - Implementon sistetemin bazik të informimit shëndetësor SISH dhe përmirëson statistikat ekzostuese;
 - Implementon ligjin per ndalim te pirjes se duhanit ne hapsirat e institusionit ,
 - Zbaton programe për menagjim të hedhurinave dhe materialet e kontaminuara ,
 - Zbaton sistemin obligativ për sterilizim;
 - Zbaton sistemin e kontrollit të infeksionit;
 - Zbaton sistemin e hapjes së kartonave –dosjes për qdo pacient;
 - Zbaton sistemin e managjimit të resurseve humane;
 - Zbaton sistemin për mirëmbajtjen e paisjeve dhe ndertesave
 - Zbaton sistemin e Planit emergjent;
 - Zbaton programet sesione keshilluese për hipertension dhe diabet;

- Zbaton sistemin e programit adekuat për furnizim , deponim dhe shpërndarjen e barërave;
- Zbaton sistemin e satisfakcionit të pacientit dhe ofruesëve të shërbimeve shëndetësore;
- Zbaton sistemin për edukimin e stafit në shkathëtësit interpersonale , gjë që siguron që pacientët janë trajtuar me dinjitet dhe respekt;
- Minimizon procedurën e vetreferimit (nga ana e pacientit) për ne shërbimet sekondare dhe terciare.
- Zbaton sistemin e ankesave të pacientëve;
- Zbaton sistemin e konfidencialitetit;
- Zbaton sistemin për dhënje të pëlqimt
- Zbaton sistemin për të drejtat e pacientëve për informim dhe vendosje.
- Zbaton sistemin e performancës lidhur me ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetsore.

IV. Të gjitha këto që u cekën më lartë rezultojnë përmes implementimit të Mjekësisë Familjare që është domosdoshmëri, implementimi I Projekt-programit, ku planifikohen të bëhet:

- Zbatimi I project planit sipas zonimit në teritorin e komunës, ku si kriter bazë është numri I banorëve, struktura kadrovike, mjetet e punës dhe objektet e punës;
- Numri kodues I hapjes së kartonave neper qendra, ku planifikojmë që në të ardhmën çdo qender të ketë mjekun familjar, të cilët mjek do të specializohen nga kjo degë;
- Do të organizojmë edukim të vazhdueshëm profesional për qytetarët e të gjitha moshave sipas programeve kundër HIV/AIDS, pirjes së duhanit aktiv dhe pasiv, alkoolit, narkomanisë, prostitucionit, planifikimit familjar ,sesionet keshilluese për diabet dhe hypertension si dhe tema tjera sipas nevojës;
- Planifikojmë dhe qdo herë synojmë që edhe për kundër vështirësive buxhetore – financiare që të adaptojmë ordinancat – lokalet ashtu siq kerkohet sipas standardeve të M.F., sigurimi I tensiometrave statik për infermiere të bëhet kompjuterizimi dhe lidhja me intranetit në menyrë qendrore për të I ikur regjistrimit të shumëfishtë të pacientëve.
- Planifikojmë që seciles QMF dhe AMF në terren të përmirësohet infrastruktura, adaptimi ose ndertimi I objekteve shtesë sipas nevojës

Planifikojmë që një mjek për 2000 banorë, sipas standardeve të M.F., dhoma e pritjes së pacientëve duhet të jetë e vetme(dhoma e triazhimit), ose e përbashkët me njisinë tjetër të M.F., ku në këtë vend duhet të ketë ulëse pritëse, televizor me program edukativo-shëndetësor, të kenë të vendosura postere në mure që kanë qëllim edukativo-shëndetësor, revista shëndetsore dhe broshura:

- Në dhomen e triazhit duhet të jetë Infermierja , e cila do të ketë kontaktin e parë me pacientin , ku do të informohet për qëllimin e ardhjes , e gjënë kartelen shëndetësore ia mat T.A., peshën, gjatësinë, pulsën, frymarrjen dhe e dërgon te mjeku me të dhëna të mjaftueshme, si dhe pas kontrollit te beje edukim shendetesor te pacientit:
- Dhoma e mjekut duhet të jetë e kompletuar me aparaturë për diagnostifikim të pacientit, kontrollohet pacienti, I përshkruhet terapia, I caktohet termini I vizitës së ardhshme, ku përmes karteles informierja –motra I jep këshilla te nevojshme lidhur me perdorim të barërave dhe sëmundjen

Nga projektet tjera që presim të I realizojmë në këtë vit janë:

1. Projekti për zgjerimin e lokaleve në shërbimin e Laboratoriumit duke bërë përshtatjen e duhur.
2. Projekti për kyqjen e sistemit të nxemjes qendrore në QMF dhe AMF ne terren.
3. Prejekt dhe kerkesë për furnizim me baran sipas kërkesës nga lista esenciale, kompletim me mjete medicinale dhe inventar për QMF
4. Projekti për ndertim te një aneksi shtesë në objektin e QMF në Tërstenik dhe zgjerim të objektit;
5. Propozojmë qe QMF Komoran të punoj 24 h. dhe të ndertohet object I ri.
6. Propozojmë që të hapen shërbime laboratorike në 3 QMF-të në terren.
7. Propozojmë të hapen shërbime stomatologjike në QMF Komoran dhe Terstenik,
8. Në AMF Sankoc te renovohet kulmi dhe të gelqerost objekti;
9. Në QMF Gllanasellë dhe AMF Abri të ndrrrohen dyrt dhe dritaret, dhe të gelqeroret;

Për të gjitha këto kërkohet një sigurim I mjeteve financiare –buxhetit dhe angazhim I stafit udhëheqëse ne bashkëpunim me strukturat komunale dhe ato qendrore.

Gjatë vitit 2018 QKMF “Dr.Hafir Shala” Drenas do të funksionoj me këtë departamente , sektore, QMF, AMF dhe sherbime tjera si vijon:

1. Departamenti I M.F.

- I. Sektori I M.F.;
- II. Sektori I shëndetit public;
 - Njësia e SISH-it;
 - Njësia e imunizimit dhe
 - Njësia e vaksinimit.
- III. Sektori I shëndetit oral ne Drenas
- IV. Sektori I kujdesit emergjent
- V. Sektori konsultativ
 - Njësia e Pediatrisë;
 - Njësia e Gjinekologjisë;
 - Njësia e Dermatologjisë
 - Njësia e Radiologjisë
- VI. Sektori I diagnostikës:
 - Kabineti radiologjik dhe
 - Laboratorit;
 - Departamenti I administratës:
 - Njësia apo zyra e personelit;
 - * Njësia po zyra juridike;
 - * Njësia apo zyra e buxhetit dhe financave;
 - Njësia apo zyra e sherbimeve teknike;
 - Njësia apo zyra e kryetchnikut;

VII. Materniteti –Lindtorja:

VIII. Barnatorja qendrore;

X. Njësia apo zyra e Koordinatorit për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, arovuar nga Ministria e shëndetsisë dhe DSHMS Drenas.

Ne kuader të QKMF-së “Dr.Hafir Shala” Drenas për vitin 2018 planifikohet dhe vazhdojnë të veprojnë dhe punojnë 5 QMF dhe 7 AMF ne terren e këto janë:

- QMF Bushat;
- QMF Qendresë
- QMF Arllat;
- QMF Rezistencë;
- QMF Shkabë;
- Ambulanca Abri e Eper;
- Ambulanca Grykas;
- Ambulanca Nikaj;
- Ambulanca Flamuras;
- Ambulanca Dritan;
- Ambulanca Dodonë;
- Ambulanca Malës.

QKMF “Dr.Hafir Shala” Drenas duke marrë përbazë shtimin e nr.banorëve në teritorin e komunës së Drenasit dhe banorëve të komunave tjera, si dhe kujdesin e shtuar për ofrim dhe ngritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore ne plan ka paraparë që vëllimi fizik I shërbimeve shëndetësore në këtë vit kalendarik të jetë I shtuar për 4% në krahasim me vitin 2018. Gjithashtu nevoitet që edhe Plani financiar –buxheti për këtë vit të jetë më I rritur për 4%. Për punën e gjithëmbarshme për vitin kalendarik 2018 janë të detyruar të raportojnë Departamentet – sektoret dhe sherbimet tjera –Komiteti për ngritjen e cilësisë dhe këshilli drejtues, me qëllim që punëtorët të njoftohen mbi rrjedhën dhe procesin e punës, sherbimet e ofruara, të drejtat dhe obligimet e punëtorëve dhe pacientëve, si dhe çështje tjera. Raporti I punës paraqitet nga ana e shefit të departamentit – sektorit, apo sherbimit sipas këtyrë termineve kohore:

Departamenti –Sektori -Sherbimi	Termini	Organit Kompetent
Departamenti –Sektori I M.F.	Qdo 3 muaj	1. Komitetit për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe 2. Këshillit drejtues
Sektori I shendetit public -Njësia e SISH-it -Njësia e Imunizimit; -Njësia e Vakcinimit	“ “	“ “
Sektori I shendetit oral	“	“
Sektori I kujdesit emergjent	“	“
Sektori konsultativ - Njësia e Pediatrisë - Njësia e Gjinekologjisë -Njësia e Dermatologjisë -Njësia e Radiologjisë	“	“
Sektori I diagnostikes -Kabineti I Rengenit; -Laboratoriumi	“ “	“ “
Departamenti I Administratës -Njësia apo Zyra e Personelit; -Njësia apo Zyra Juridike; -Njësia apo Zyra e buxhetit dhe financave; -Njësia apo Zyra për shërbime teknike;	“	“
Materniteti - Lintorja	“	“
Barnatorja Qendrore	“	“
Njësia apo Zyra e Koordinatorit për ngritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.	“	“
Njësia apo zyra e kryeteknikut	“	“